

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRY OF INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP AND TRADE
Nr./Br./No. 526/19
Data/Datum/Date 01.02.2024
PRISHTINE



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA E APELIT PRISHTINË
23.01.24

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:092271
Datë: 17.01.2024
Numri i dokumentit: 05203850

Ka. nr. 2/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Azra Cakolli kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Skender Çoçaj anëtarë, në çështjen kundërvajtëse ndaj të pandehurës Operatorit Ekonomik “Ex Fis” SHPK, NUI 810536998, me Drejtor menaxhues Lum Muharremi, Njësia nr.41, për kundërvajtje nga neni 6 par. 1 dhe par. 2 pika 2.6 sanksionuar sipas nenit 19 par. 2 pika 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të ripërtrishme duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga e pandehura - Operatori Ekonomik “Ex Fis” SHPK, përmes mbrojtësit sipas autorizimit Nebih Troshupa, avokat nga Lipjani, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr.137/2023, të datës 13.12.2023, në bazë të nenit 55 par. 3 dhe neni 78, konform të nenit 143 par. 1 dhe 3 të Ligjit për Kundërvajtje, Nr. 05/L-087, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 16.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paraqitur nga e pandehura Subjektit Ekonomik “Ex Fis” SHPK, NUI 810536998, me Drejtor menaxhues Lum Muharremi, Njësia nr.41, si person juridik, ndërsa **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Klinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr.137/2023, i datës 13.12.2023, si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Klinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, duke vendosur sipas Kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të ushtruar nga ana e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë – Inspektorati i Tregut, me numër të Ref. 19/2022, të datës 29.03.2023, dhe me numër të protokollit 1782, me aktgjykimin K.nr. 137/2023, të datës 13.12.2023, të pandehurën Operatorin Ekonomik “Ex Fis” SHPK, NUI 810536998, me Drejtor menaxhues Lum Muharremi, Njësia nr. 41, e ka shpallë përgjegjëse sepse:

- Sepse:

Si subjekt i regjistruar për shitjen me pakicë të derivateve të naftës, nga dita e pa caktuar e deri më datë 22.02.2023 në Klinikë në rrugën “Mirush Daka”, saktësisht në pikën e karburantit “Ex Fis” njësia nr.41 ka ushtruar veprimtarinë e shitjes me pakicë të derivateve të naftës Dizel dhe Benzinë (NDN), pa licencë aktuale valide të lëshuar nga Këshilli i MINT-së, në atë mënyrë që me rastin e inspektimit nga Inspektorët e Inspektoratit të Tregut të MTI-së, i është dhënë afat 30 ditorë, që ta prezantoj licencën e kërkuar mirëpo i njëjti edhe pas kalimit të këtij afatit nuk ka arritur të pajiset me licencën e kërkuar asnjëherë, -

-me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 6 par.1 dhe 2 pika 2.3. të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme, andaj në bazë të nenit 19 par. 2 pika 2.1. të ligjit të lartë cekur, e i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 5000 (pesëmijë)€, të cilin ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa nëse gjoba nuk paguhet vullnetarisht brenda afatit të lartë cekur do të inkasohet detyrimisht konform Ligjit për Procedurën Përmbarrimore.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale paushallë të paguaj shumën prej 15(pesëmbëdhjetë)€, në të njëjtin afat sikurse edhe dënimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë i pandehuri Operatorit Ekonomik “Ex Fis” SHPK, përmes mbrojtësit sipas autorizimit Nebih Troshupa, avokat nga Lipjani, për vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, në të cilën veç tjerash thekson:

Gjykata nuk e ka pas parasysh se subjekti e ka marrë pikë me qira në gjendjen në të cilën ka qen duke operuar dhe pastaj i ka filluar procedurat për plotësimin e kushteve për pajisje me licencë për të kompletuar të gjitha dokumentet në ç rast e ka dorëzuar Kërkesën MINT-së, po ashtu nuk i ka marr parasysh provat e të pandehurit pasi që MINT-së, nuk ka qen fleksibile për lëshimin e dokumentacionit në ç rast operatori u detyrua të bënë dy Kërkesa për marrjen e Licencës, çka ka dëshmuar edhe në gjykatë. Po ashtu gjyqtari nuk ka caktuar ekspertizë për vërtetimin e gjendjes faktike dhe për të vendosur drejt lidhur me këtë çështje. Po ashtu gjykata ka aplikuar gabim të drejtën materiale duke e dënuar të pandehurin me gjobë në shumë prej 5000€, duke mos e marr parasysh asnjë rrethanë lehtësuese, konsiderojnë se dënimi i shqiptuar është shumë i lart, i pa bazuar në fakte dhe i pa vërtetuar.

I propozon Gjykatës së Apelit - Divizioni i Kundërvajtjes, të aprovohet ankesa në tersi si e bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta Ndryshoj, pasi që gjyqtari i rastit nuk ka hapur seancë.

Kolegji i kësaj gjykate, duke i vlerësuar thëniet në ankesë, aktgjykimin e goditur si dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se ankesa e paraqitur nga i pandehuri Operatori Ekonomik “Ex Fis” SHPK, përmes mbrojtësit sipas autorizimit Nebih Troshupa, avokat nga Lipjani, nuk është e bazuar andaj edhe u refuzua.

Kolegji konstatoj se gjykata e shkallës së parë, me rastin e zhvillimit të procedurës për veprën kundërvajtëse, Përfaqsesi i të pandehurës Lum Muhaxhiri, e ka shfrytëzuar të drejtën ligjore të mos deklarohet lidhur me përgjegjësin e personit juridik dhe se Mbrojtësi me prokurë Nebih Troshupa, avokat nga Lipjani, ka deklaruar se e kundërshton Kërkesën e ushtruar si të pa bazuar, pasi që kjo pikë Njësi në Klinikë është marr me qira dhe se e njëjta ka qen e pajisur me leje pune mirëpo inspektorët kanë kërkuar që ta prezanton licencën në ç rast ka ushtruar Kërkesë për Licencë në MINT-së, dy herë, në bazë të Procesverbalit mbi dëgjimin e ushtruesit të kërkesë Taulant Krasniqit, inspektor i tregtisë në MINT-së, në cilësi të dëshmitarit i cili ka mbet në tëri pranë kërkesës së ushtruar pasi që e pandehura ka ushtruar veprimtarinë pa Licencë, në bazë të Procesverbalit mbi inspektimin e kryer nr. 00057 të datës 22.02.2023, i cili është nënshkruar pa vërejte, si dhe në bazë të shkresave tjera të lëndës padyshim se e ka vërtetuar gjendjen faktike se e pandehura ka kryer veprën kundërvajtëse të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit të goditur, për të cilën mbanë përgjegjësi kundërvajtëse.

Kjo gjykatë i vlerësoi sipas detyrës zyrtare dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse e as shkelje tjera për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, në të nuk ka kundërtënie me vetveten e as me arsyet e tij,

është i qartë dhe konkret. Aktgjykimi i kundërshtuar përmban arsyet e duhura mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje kundërvajtëse. Pra gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë seancës gjyqësore dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit të Kosovës duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lart, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në këtë çështje kundërvajtëse nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar. Gjithashtu, me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur as ligji procedurës kundërvajtëse siç pretendohet në ankesë. Kjo për faktin se veprimet e të pandehurit i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës kundërvajtëse për të cilën i njëjti është shpallur përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen apo përgjegjësinë kundërvajtëse të pandehurit. Gjithashtu kolegji i kësaj gjykatë ka shqyrtuar edhe çështjen përkitazi me vendimin për dënim dhe vlerësoj se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimi të llojit dhe lartësisë së dënimit i ka shqiptuar dënimin duke pas parasysh të gjitha rrethanat konform dispozitës së nenit 35 dhe 31 të LK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Konform të nenit 143 par.1 dhe par. 2 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,
Ka.nr. 2/2024, të datës 16.01.2024



KRYETARJA E KOLEGJIT

Azra Cakolli